

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit nëntor, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 5 mbledhje, që kanë rezultuar në 19 vendimmarrje, ndër të cilat:

Licencimin e shoqërive:

- “Delta Plan Studio” shpk dhe “ORHER” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet 2MW secila, me vendndodhje në qarkun Fier, për një afat 30 vjeçar për shoqërinë “Delta Plan Studio” shpk dhe 25-vjeçar për shoqërinë “ORHER” shpk; “Axpo Albania” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 21.12.2024.

Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive:

- “Volton” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
- “Mountain’s Green Energy” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 1975 kW, me vendndodhje në Bashkinë Vau Dejës, për një afat 30-vjeçar.

Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesave të shoqërive si më poshtë:

- Për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërive:

- i. “REBESOL” shpk deri me 26.01.2025
- ii. “SAMASOL” shpk deri me 27.01.2025
- iii. “ZENINA” shpk deri më 26.01.2025
- iv. “DRIBEN” shpk deri më 21.12.2024

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Zgjatje të afateve vendimmarrëse

Tarifa dhe çmime

Metodologji

Aktivitete

Platforma PCT

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesave të OST sh.a.:

- Për disa shtesa dhe ndryshime në “Metodologjinë e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës
- Për disa shtesa dhe ndryshime në “Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri - Kosovë”
- Për miratimin e “Rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionëve”.

ERE është përgjegjëse për zhvillimin e metodologjive të tarifave dhe çmimeve për aktivitetet e rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazuar në analizat e saj propozon përmirësime të metodologjive ekzistuese.

Sa i përket kësaj fushe përgjegjësie, gjatë muajit nëntor janë marrë vendime mbi:

- Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2024 prej 14.19 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Për më shumë informacion në lidhje me cmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të miratuara nga ERE gjatë vitit 2024, referojuni faqes së ERE, www.ere.gov.al

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

Vendime të tjera si:

- Dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik “Blue 1” i shoqërisë “SPV Blue 1” shpk, për periudhën 01-31 gusht 2024 për sasinë 13,543 MWh.
- Miratimin e një ndryshimi në “Kodin e Rrjetit TAP” dhe “Kodin Tarifor TAP”.
- Vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë në platformën e krahasimit të çmimeve të krijuar nga ERE (PCT) si dhe të publikojnë ofertat e furnizimit duke përcaktuar afatet e vlefshmërisë për çdo ofertë të publikuar. (<https://pct.ere.gov.al/>)
- Fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit të investimeve të shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025 – 2027.
- Fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë dhe miratimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të propozuar nga OST sh.a. të depozituar në ERE më datë 05.11.2024. Në pikën 2 të vendimit Nr. 43, datë 15.03.2017 sipas të cilit ERE ka vendosur “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., përcaktohet që i licencuari duhet të caktojë Zyrtarin e Pajtuëshmërisë, i cili do të jetë subjekt i miratimit nga ERE. Deri në përfundimin e procesit të emërimit të zyrtarit dhe miratimit të kontratës së ofrimit të shërbimit të zyrtarit nga ERE, detyrat dhe funksionet e zyrtarit të pajtuëshmërisë së OST sh.a të kryhen nga zyrtari i miratuar nga ERE me vendimin 50/2021.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit nëntor janë zhvilluar 6 seanca dëgjimore, me konsumatorë por dhe të licencuar, me qëllim sqarimin e detajeve të nevojshme për zgjidhjen e ankesave përkatëse, apo vazhdimin e procesit të licencimit të subjektit në fjalë.

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me regjistrat e [licencimit të subjekteve](#), [të garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave](#) të rifreskuar, si dhe [tarifa dhe çmime](#) të miratuara nga ERE.

ERE në nëntor ka nisur konsultimin për propozimet e mëposhtme, palët e interesit janë të mirëpritura të dërgojnë opinionet e tyre në adresën erealb@ere.gov.al:

- [Shtesat dhe ndryshimet e propozuara nga OST sha në lidhje me Metodologjinë e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike Brenda të Njëjtës Ditë Shqipëri – Kosovë;](#)
- [Kërkesë për marrjen në shqyrtim të ndryshimit të afatit të nominimit në tregun e balancimit;](#)
- [Propozime mbi disa ndryshime në rregullat e tregut të energjisë elektrike.](#)

Gjithashtu ju ftojmë të shfletoni të dhënat e fundit të tregut të energjisë në vend, ku do të gjeni raporte periodike mbi monitorimin e tregut të energjisë dhe aktivitetin e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike për 9-mujorin e parë të vitit 2024 si dhe [të dhënat e tregut të energjisë për 9-mujorin e vitit 2024.](#)

Pjesmarrja në Panairin e energjisë, ndërtimit dhe ekonomisë së gjelbër



Z. Gledis Kalem, Drejtor në Drejtorinë e zhvillimit të politikave dhe mbikqyrjes së burimeve të rinovueshme të energjisë në ERE, ishte dje pjesë e panelit të dytë të Forumit në Panairin e energjisë, ndërtimit dhe ekonomisë së gjelbër që po zhvillohet këto ditë në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Ky panel, me fokus në implementimin e agjendës së gjelbër në tregun vendas të energjisë, i dha rëndësi të veçantë rolit të ERE-s mbi hartimin dhe miratimin e kuadrit rregullator në përputhje me dinamikën e zhvillimit të tregut të energjisë, i cili mundëson, lehtëson dhe nxit integrimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në sistemin elektroenergjetik shqiptar. Gjithashtu, u diskutua mbi ecurinë e diversifikimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, ku fokusi i vendit tonë tashmë është energjia diellore dhe ajo e erës; si dhe mbi forcimin e rolit të konsumatorit, duke u kthyer tashmë në proaktiv nëpërmjet vetë-gjenerimit të energjisë elektrike dhe mundësisë për të krijuar komunitete lokale të energjisë.